VENDIM
Nr. 199, datë 10.4.2019

PËR PËRCAKTIMIN E KRYETARIT DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE, PËRFAQËSUES TË PUSHTETIT QENDROR, NË KËSHILLIN DREJTUES TË FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT

(Ndryshuar me vendimin nr. 77, datë 10.2.2021; nr. 143, datë 11.3.2022)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e zëvendëskryeministrit, *z. Arben Ahmetaj,* kryetar të këshillit drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.
2. Emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si më poshtë vijon:
- znj. Elva Margariti, ministër i Kulturës;
- znj. *Adela Xhemali,* zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë;
- znj. Ornela Çuçi, zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit;
- *znj. Edona Bilali, ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.*
3. Vendimi nr. 982, datë 25.10.2013, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kryetarit dhe emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit", i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe